

Mundësi për të marrë pjesë në URBACT City Festival 2025, që do të organizohet nga programi URBACT

Ky festival, që organizohet nga URBACT, do të mbledhë 600 përfaqësues të bashkive nga e gjithë Evropa për të ndarë njohuri dhe praktikat e mira urbane, si dhe për të krijuar rrjetëzim dhe bashkëpunim mes tyre për përmirësimin e qyteteve.

Data dhe vendndodhja:

Festivali i vitit 2025 do të zhvillohet në qytetin e **Wroclaw, Poloni**, nga data **8 deri më 10 prill 2025**.

Çfarë do të prezantohet në këtë event?

- Prezentimi i 116 praktikave të mira urbane të bashkive që janë pjesë e programit URBACT-it, të cilat janë të lehta për t'u transferuar dhe kanë impakt të madh për zhvillimin e qyteteve.
- Marrja e njohurive të detajuara mbi thirrjen për Rrjetet e Transferimit të URBACT-it, që do të hapet nga prilli deri në qershor 2025, duke ofruar mundësinë për të transferuar praktikat e mira në qytetin tuaj.
- Hapësira për të ndërtuar partneritete mes qyteteve pjesëmarrëse dhe për të eksploruar mundësi të reja bashkëpunimi.
- Eksperiencë direkte të praktikave të mira të qytetit Wroclaw.

Kush mund të marrë pjesë në të?

- Përfaqësues të administratave të bashkive nga e gjithë Evropa, Njësitë e Integritimit Evropian dhe të zgjedhur lokalë.
- Përfaqësues të autoriteteve rajonale dhe metropolitane.
- Përfaqësues të Komisionit Evropian dhe organizatave të financuara nga BE.
- Përfaqësues të Praktikave të Mira
- Anëtarët e Rrjeteve aktuale të Planifikimit të Veprimit
- Anëtarët e Rrjeteve aktuale të Transferimit të Inovacionit
- Përfaqësues të Bashkive që nuk janë pjesë e URBACT, por që janë nga e gjithë Evropa
- Pikat e Kontaktit Kombëtare të Programit URBACT

Pse duhet të merrni pjesë?

- Për t'u njohur me praktikat e mira që funksionojnë në bashkitë evropiane.
- Për të sjellë ide të reja dhe zgjidhje të reja për sfidat e bashkisë tuaj.
- Për të krijuar partneritete me kolegët nga e gjithë Evropa.
- Për të mësuar mbi thirrjen për Rrjetet e Transferimit të URBACT-it.

Cfarë përfshin aplikimi?

Regjistrimi dhe pjesëmarrja në këtë festival është falas, por nuk mbulon kostot e udhëtimit dhe akomodimit. Eventi nuk do të mbahet vetëm në prezencë.

A mund të marr sponsorizim për të marrë pjesë në URBACT City Festival 2025?

Programi URBACT do të rimbursojë kostot e transportit dhe akomodimit vetëm për të ftuarit nga qytetet e Praktikave të Mira të URBACT. Informacioni për këtë do t'u jepet drejtpërdrejt përfutuesve. Të gjithë pjesëmarrësit e tjerë do të mbulojnë kostot e tyre të udhëtimit dhe akomodimit.

Linku i Aplikimit:

<https://eu.eventscloud.com/2025-urbact-city-festival>

Linku i Thirrjes:

<https://urbact.eu/news/save-date-urbact-city-festival-2025>

<https://urbact.eu/city-festival-2025/register-now>